

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-16/03-06

Prishtinë, më 23 shkurt 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për arsimin dhe aftësimin profesional,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Institutit gjyqësor të Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjent,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për markat tregtare,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e pjesëtarëve të luftës së UÇK-së, familjeve të dëshmorëve dhe viktimave civile të luftës,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për bujqësi, mjedis dhe planifikim hapësinor lidhur me Projektligjin për banim,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore dhe dokumenteve pedagogjike,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera,
12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit.
13. Propozimi i Kryesisë së Kuvendit për rendin e ditës për seancën plenare më 16 mars 2006.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës së kësaj seance.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Januz Kastrati (LDK) paraqiti problemet e vërshimeve në komunën e Malishevës, që kishin ndodhur si pasojë e reshjeve të mëdha.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërko që në seancën e sotme të diskutohen edhe këto çështje: a) zbatimi i standardeve; b) çështja e privatizimit dhe c) Çështja e telefonisë mobile.

Besa Gaxheri (LDK) ngriti shqetësimet e artistëve të Kosovës lidhur me privatizimin e hotelit “Union”. Ajo kërko nga Qeveria e Kosovës që të ndikoj në AMK, që mos të privatizohet hotelit “Union”.

Berat Luzha (PDK) ripësëriti problemet lidhur me bllokimin e rrugës Prishtinë – Hani i Elezit, në Grykën e Kaçanikut. Ai kërko që kjo çështje të diskutohet në seancën e sotme.

Gjelnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kërko që Kuvendi të mbaj seancë të veçantë lidhur me bisedimet e Vjenës, para 16 shkurtit 2006.

Sabit Rrahmani (IRDK) kërko që Qeveria e Kosovës të ndërmerr veprime konkrete për zhvendosjen e banorëve romë nga Kampi i Plementimit, në Mitrovicë në një vend të përshtatshëm për banim.

Teutë Sahatçiu, në emër të grupit Parlamentar të ORA-s, tha se i mbështetë kërkesat e parafolësve të saj.

Emrash Xhemajli (LPK) kërko që Kuvendi të mbajë seancë të veçantë për të debatur lidhur me takimin e Vjenës.

Ramë Buja, anëtar i Kryesisë, kërko nga ministri Qemajl Ahmeti t’i informoj deputetët e kuvendit lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës për ta zhbllokuar rrugën Prishtinë – Hani i Elezit, në Grykën e Kaçanikut.

Pas këtyre diskutimeve, Kuvendi me kërkesë të kryeministrit vendosi të hiqen nga rendi i ditës shqyrtimin e dytë të Projektligjit për trashëgiminë kulturore dhe shqyrtimin e dytë të projektligjit për ushqimin, me kërkesë të komisionit funksional.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua me vërejtjet, me shkrim të deputetit **Mark Krasniqi** dhe vërejtjet gojore të deputetit **Nazim Jashari**, në transkriptin e seancës së mëparshme, të cilat janë përmirësuar në variantin përfundimtar të tij.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për arsimin dhe aftësimin profesional

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3 dhe 4.

Kryetari e hodhi në votë propozimin për t'i votuar amendamentet e tjera me një votim të vetëm. Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----shumica;
Kundër----- 12.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet prej 5 deri 62 në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----66;
Kundër----- 8.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin dhe amendamentet e miratuara. Rezultati ishte:

Për-----72;
Kundër----- 6.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash **miratoi** Ligjin për arsimin dhe aftësimin profesional.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Çështje Gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtuese.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe17.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 74.
Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash **miratoi** Ligjin për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjent

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3(n), 4, 5, 6, 7, 8, 9,10 dhe 11.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 80.

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash **miratoi** Ligjin për kujdesin shëndetësor emergjent.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për markat tregtare

Pas kësaj kohe, seancën e kryesoi Gazmend Muhaxheri, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues dhe të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1.

Në amendamentin 2 pati vërejtje kryetari i komisionit Funkcional, Fatmir Rexhepi. Pas diskutimeve të Hydajet Hyseni, Nekibe Kelmendi, Ramadan Kelmendi, Bajrush Xhemajli dhe Kolë Berisha, kryesuesi dha pauzë, që Komisioni funksional dhe ai i Çështjeve Legjislative t'i harmonizonin qëndrimet rreth amendamentit 2.

Pas pauzës, riformulimin e amendamentit 2 e paraqiti Hydajet Hyseni, kryetar i Komisionit Këgjislativ.

Kryesuesi vazhdoi të hedh në votim amendamentet një nga një. Kuvendi miratoi amendamentet: 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19. Amendamentet prej 20 deri 38 Kuvendi i miratoi me një votim.

Kryesuesi e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 76,

Kundër----- 5.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për markat tregtare

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi Nexhat DACI, kryetar i Kuvendit.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e pjesëtarëve të luftës së UÇK-së, familjeve të dëshmorëve dhe viktimave civile të luftës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Opinione dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Flora Brovina, Naser Osmani, Nait Hasani dhe Jakup Krasniqi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari i hodhi në votë, veç e veç, secilin amendament të Komisionit për shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 80.

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, **miratoi** Ligjin për të drejtat e pjesëtarëve të luftës së UÇK-së, familjeve të dëshmorëve dhe viktimave civile të luftës.

7. Shqyrtimi i raportit i Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për banim

Deputeti **Luzim Zeneli** e arsyetoi, para deputetëve të Kuvendit, raportin e Komisionit për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për banim.

Kryetari e hodhi në votim raportin e Komisionit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68,

Kundër-----3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Projektligji për banim i kthehet propozuesit – Qeverisë së Kosovës, për ripunim.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore dhe dokumenteve pedagogjike

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Agim Veliu, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri
Në vazhdim, ministri **Veliu** shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.
Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Veliu**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nimon Alimusa, Nuran Malta, Sabri Hamiti, Sala Ahmetaj, Mazllun Kumnova, Genc Gorani, Fetah berisha, Zyhrije Maloku, Nexhmije Doçi, Ragip Zekolli dhe Nexhat Rexha**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 72;
Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash **miratoi në parim** Projektligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore dhe dokumenteve pedagogjike.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, rini dhe Sport - Komision përgjegjës për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja Melihate Tërmkoli, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri
Në vazhdim, ministrja **Tërmkoli** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore për zbatimin e këtij projektligji.
Pas arsyetimit të këtij projektligji nga , ministrja **Tërmkoli**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Agim Krasniqi, Berat Luzha, Ymer Halimi, Xhezair Murati, Ramaadan Kelmendi, Fadil geci, Hydajet Hyseni, Qibrije Hoxha, Ibush Jonuzi dhe Behxhet Brashori**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 77;
Kundër----- 2.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e miratoi në **parim** Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Gatishmëri dhe Emergjencë-Komision përgjegjës - raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

10. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Këshillin e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Grupet parlamentare nuk i kishin harmonizuar qëndrimet për t'ia propozuar Kuvendit tre anëtarë për Këshillin e Agjencisë, siç i kishte ngarkuar seanca e mëparshme, por secili grup Parlamentar kishte propozuar nga një kandidat.

Kryetari i hodhi në votim kandidatët e grupeve parlamentare, sipas numrit të deputetëve që kanë në Kuvend.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e **Grupit Parlamentar të LDK-së**, që kishte propozuar deputetin **Sadudin Berisha**. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----56;
Kundër----- 20.

U votua propozimi i **Grupit Parlamentar të PDK-së** për deputetin **Gani Koci**. Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----42;
Kundër—37.

U votua propozimi i **Grupit Parlamentar të AAK-së** për deputetin **Ymer Halimi**. Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----61;
Kundër-----17.

Propozimet e grupeve tjera parlamentare nuk u votuan, ngase ishin pa objekt.

Pastaj kryetari i hodhi në votim edhe propozimet e subjekteve tjera, të autorizuara sipas Ligjit kundër korrupsionit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----44;
Kundër----- 35.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë kundër korrupsionit

I. Në këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit emërohen këta kandidatë:

1. Sadudun Berisha, anëtar, nga Kuvendi i Kosovës,
2. Gani Koci, anëtar, nga Kuvendi i Kosovës,
3. Ymer Halimi, anëtar, nga Kuvendi i Kosovës,
4. Adem Loxhaj, anëtar, nga Zyra e kryetarit të Kosovës,
5. Habit Hajredini, anëtar, nga Zyra e kryeministrit të Kosovës,
6. Fejzullah Hasani, anëtar, nga Gjykata Supreme e Kosovës,
7. Besim Kelmendi, anëtar, nga Prokuroria Publike e Kosovës,
8. Ragip Gajraku, anëtar, nga Asociacioni i komunave të Kosovës dhe
9. Bashkim Rrahmani, anëtar, nga Shoqëria Civile (FDI).

II. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Agjencisë kundër korrupsionit zgjat dy (2) vjet.

10. Miratimi i rendit të ditës për seancën e radhës

Kuvendi, pas shqyrtimit të propozimit të Kryesisë për rendin e ditës të seancës së radhës, nxori këtë

Përfundim:

1. Kuvendi e miratoi rendin e ditës për seancën plenare të 16 marsit 2006, në formën e propozuar.
2. Kërkesat e grupeve parlamentare për shqyrtimin e çështjeve plotësuese t'i përcillen Kryesisë së Kuvendit për radhitje në rend dite të seancave të radhës.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 16:35 minuta.

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik **Nexhat Daci**